

PYETJET MË TË SHPESHTA

Më është dërguar kopja e dokumenteve të palës tjetër por nuk mund t'i lexoj pasi që janë në shqip/serbisht?

Nëse keni pranuar një kopje të dokumenteve të Paraqitësit të Kërkesës apo Palës Përgjegjëse në kërkesë por nuk mund t'i lexoni pasi që janë në gjuhën, të cilën ju nuk e kuptoni (p.sh. shqip apo serbisht), atëherë ju mund të aplikoni në AKP për ndihmë që dokumentet të përkthehen për ju.

AKP-ja do të ndihmojë dhe do të ofrojë përkthimin e disa dokumenteve të kërkesës, vetëm për personat të cilët janë në gjendje të vështirë financiare. Një person konsiderohet të jetë në gjendje të vështirë financiare nëse ai/ajo mund të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të treguar se të ardhurat e tyre të përgjithshme mujore në familje, minus shpenzimet e tyre mujore, janë shumë të vogla që të mund të paguajnë për përkthimin e dokumenteve.

Personat, të cilët nuk janë në gjendje të vështirë financiare pritet që të organizojnë vet përkthimin e dokumenteve të cilat u janë dërguar.

Si mund t'i dëshmoj vështirësitë e mia financiare?

Ju duhet të plotësoni formularin të cilin mund ta:

- shkarkoni nga ueb faqja e AKP-së në <http://www.kpaonline.org/faq.asp> dhe duke klikuar në FAQ numër 10; ose
- merrni në ndonjërin nga zyrat e AKP-së në Kosovë, Maqedoni apo Mal të Zi, apo në secilën Zyrë Pronësore të UNHCR-së në Serbi (ju lutem referojuni listës e cila përmban detajet kontaktuese në fund të këtij dokumenti).

Kur ta shkarkoni formularin nga ueb faqja e AKP-së apo të merrni një kopje në AKP/Zyrën Pronësore të UNHCR-së, duhet ta plotësoni formularin dhe duhet ta dorëzoni personalisht në ndonjërin nga zyrat e lartpërmendura, së bashku me të gjitha dokumentet e rëndësishme për të ardhurat tuaja, shpenzimet mujore dhe pasuritë, përfshirë: pasqyrat e të ardhurave për të gjithë personat anëtarë të familjes suaj, pasqyrat bankare, kartelat e ndihmës sociale apo dëshmitë se pranoni ndihmë sociale, dëshmitë se paguani qira, faturat e shërbimeve publike (energjisë elektrike, ujësjellësit), shpenzimet mjekësore dhe çdo dokument tjetër të rëndësishëm financiar. Personeli i AKP-së/Zyrës Pronësore të UNHCR-së do t'ju ndihmojë në kërkesën tuaj dhe do të dërgojë aplikacionin dhe kopjet e dokumenteve mbështetëse në ZQ të AKP-së që të merret vendimi nëse keni të drejtë për ndihmë në përkthim. Për të marrë këtë vendim, ZQ -së së AKP-së i nevojitet një muaj dhe mandej do të njoftoheni më shkrim për rezultatin. Nëse konsiderohet se nuk keni të drejtë në një ndihmë të tillë, ju mund të ankoheni ndaj këtij vendimi në AKP siç është sqaruar në aplikacion.

Cilat dokumente do të përkthehen?

AKP-ja nuk do t'i përkthejë të gjitha dokumentet të cilat do t'ju dërgohen, por vetëm ato dokumente të cilat konsiderohen të jenë të rëndësishme në kërkesë, apo në çështjet që janë kontestuese në kërkesë. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me përkthimin e ndonjë dokumenti të veçantë, atëherë ju duhet të kontaktoni AKP-në/Zyrën Pronësore të UNHCR-të. Nëse besoni se duhet të përkthehen dokumente tjera, duhet ta dorëzoni kërkesën me shkrim në AKP.

A do të bëhet përkthimi nga përkthyesit gjyqësor?

AKP-ja do të ofrojë vetëm përkthime nga përkthyesit jo-gjyqësor. Nëse dëshironi që ndonjë dokument të përkthehet nga përkthyesit gjyqësorë, kjo është çështje e cila ju takon juve dhe ju duhet të organizoni dhe të mbuloni shpenzimet e çdo përkthimi të tillë. Nuk mund të kërkonte nga AKP-ja përkthime nga përkthyes gjyqësor.

A do të jetë AKP-ja përgjegjëse për ndonjë gabim gjatë përkthimit të dokumentacionit?

Kur të aplikoni për ndihmë në përkthim, duhet të nënshkruani deklaratën në të cilën ceket se ju e kuptoni që AKP-ja nuk merr përgjegjësinë për ndonjë pjesë, e cila mbetet e pa përkthyer apo për ndonjë gabim gjatë përkthimit nga përkthyesit jo-gjyqësor, sido që të jetë shkaktuar.

ZYRAT E AKP-së:

Selia Qendrore: "Perandori Justinian" Nr.5, Qyteza Pejton, Zyret Rajonale: Prishtinë, tel.038/249-918, fax.038/249-919; Prishtinë: "Rexhep Luci". Nr.2 tel.038/225-473, fax.038/244-854. Graçanicë: "Vidovdanit" pn, Prizren: "William Walker" p.n (në Zyrën e EULEX-it), tel. 029/231-429 dhe 029/231-469; Gjilan: "Lidhja e Prizrenit" Nr.114, tel.0280/320-289, fax.0280/324-067. Mitrovicë: "Mbretëresha Teuta" (përballë Jugobankës), tel.028/530-136, fax.028/530-139. Pjesa Veriore e Mitrovicës: Ndërtesa e AKM-së, Dhoma nr.18, Kompleksi i Stacionit Verior të UNMIK-ut/ Filipa Višnjica p.n. Tel: 063/197-6470; Pejë: "Mbretëresha Teuta" Nr.8, tel.039/431-668, fax.039/432-970; Podgoricë: "Crnogorskih Serdara" p.n tel.020/624-216; 081/623-744. Shkup: "Vihnicka" Nr. 10 (ndërtesa e CDRIM) kati i parë tel. +389 71 886 564.

Zyrat Pronësore të UNHCR-së:

Beograd: "Visegradska" Nr.23, Tel: 011/362-13-93; 362-13-94 Fax.011/361-27-48; Nish: "Dusanov Bazar (Kupola)" kati II, Zyra Nr. 210, Tel: 018 203-777; Kragujevc: "Lole Ribara" Nr. 9, kati I Tel: 034 330-234; Fax: 034 335-244